



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 20 mars 2013, në orën 10:00, sala N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.03.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për procesin e menaxhimit financiar dhe sistemet e Kontrollit në Radio- Televizionin e Kosovës, për vitin 2011, si dhe Raporti kthyes i Radio -Televizionit të Kosovës, sipas kërkesë së Komisionit;
4. Shqyrtimi i Raportit kthyes të Ministrisë së Administratës Publike, sipas kërkesë së Komisionit;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.03.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.03.2013

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për procesin e menaxhimit financiar dhe sistemet e kontrollit në Radio -Televizionin e Kosovës, për vitin 2011, si dhe Raporti kthyes i Radio-Televizionit të Kosovës, sipas kërkesë së Komisionit.

Kryetari – RTK- ja ka kthyer raport lidhur me zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it dhe planin aksional, mirëpo i njëjti, për mendimin tim, nuk ka paraparë veprim konkret se si do të adresohen këto rekomandime. ZAP ka bërë auditim të procesit të menaxhimit financiar dhe sistemet e kontrollit të RTK-së. Propozoi që ZAP të bëjë një analizë të planit aksional të RTK-së dhe t'i dorëzojë një vlerësim Komisionit lidhur me këtë plan. Po ashtu, propozoi që ZAP në sezonin e ardhshëm të auditimit të përfshijë edhe auditimin e RTK-së.

Ramiz Lladrovci – Në këtë raport nuk ka të dhëna konkrete, përveç rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i për vitin 2011. RTK, për çdo vit, është duke krijuar borxhe dhe nuk ka ndonjë plan se si të tejkalohet kjo. Të paktën kjo nuk shihet në raportin e auditimit të vitit 2011, e as në raportin kthyes të RTK-së.

Imri Ahmeti- Në raportin kthyes nuk ka veprime konkrete për adresim të çështjeve, më tepër ka konstatim të gjendjes sesa adresim të rekomandimeve të ZAP-it. Ishte i mendimit që Komisioni të ketë një vlerësim nga ZAP-i, se si është situata tani në vitin 2012, ose edhe të kërkojë një auditim të RTK-së, në sezonin e ardhshëm të auditimit, nga ZAP-i.

Artan Venhari, zëvendës auditor – Raporti i auditimit është i vitit 2011. Ka të bëjë me menaxhimin financiar, e jo me pasqyrat vjetore financiare të RTK-së. Për vitin 2011 auditimin e ka bërë një kompani e huaja e jashtme. Raportin kthyes të RTK-së, ZAP e ka pranuar nga Komisioni dhe, sipas mendimit tonë, ky raport është shumë i përgjithësuar. Pajtohem që ZAP-i të dalë me një vlerësim të veprimeve të prezantuara nga RTK dhe të përgatisë një informatë për KMFP. Po ashtu, u pajtua që ZAP në sezonin e ardhshëm të auditimit mund ta përfshijë në agjendë një auditim të PVF, ose të menaxhimit të RTK-së.

Ramiz Lladrovci – Pyeti zëvendësauditorin nëse ZAP planifikon ta bëjë vetë auditimin, apo do të angazhojë kompani të jashtme, kjo duke marrë parasysh specifikat e RTK-së?

Artan Venhari, zëvendësauditor - Kjo varet se çfarë lloj auditimi po kërkohet: i performancës, i menaxhimit, ose i PVF. Varësisht nga kjo ZAP do të vendosë për angazhimin e ndonjë kompanie, ose që kjo të bëhet nga ZAP-i.

Mursel Halilji – Rreth propozimit që RTK-së t'i bëhet auditim i menaxhimit, ose i performancës ishte i mendimit që ky auditim të fokusohet më tepër në cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga ana e RTK-së, në programe të ndryshme.

Valbona Dibra – Pati vërejtjen se Komisioni është fokusuar në shqyrtimin e Raportit kthyes të RTK-së, e jo edhe në raportin e auditimit që ZAP-i i ka bërë këtij institucioni.

Kryetari – Meqenëse raporti kthyes i RTK-së është i bazuar në rekomandimet e dala nga raporti i auditimit të RTK-së, kjo arsyeton edhe shqyrtimin e raportit kthyes.

Ramiz Lladrovci – KMFP në raportin e vitit 2010 të auditimit të RTK-së ka kërkuar raport kthyes, mirëpo RTK deri tani nuk i është përgjigjur kërkesës së Komisionit dhe kjo kuptohet se në diskutim sot kemi dy raporte: raportin e menaxhimit financiar dhe sistemet e Kontrollit në

Radio- Televizionin e Kosovës, për vitin 2011 dhe raportin kthyes të RTK-së.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë një analizë të planit aksional të RTK-së dhe t'i dorëzojë një vlerësim Komisionit lidhur me këtë plan.**
- 2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në sezonin e ardhshëm të auditimit, të bëjë auditim të performancës, ose auditim të menaxhimit të RTK-së.**

4. Shqyrtimi i Raportit kthyes të Ministrisë së Administratës Publike, sipas kërkesë së Komisionit.

Kryetari - Njoftoi anëtarët se sipas kërkesës së Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, ministri i MAP-it ka dorëzuar raportin kthyes, i cili përmban përgjigjet në interesimet e Komisionit.

a). Trajtimi i stoqeve

Kryetari - MAP ka për menaxhim dy depo: depon te Rilindja (ka material sanitar, elektrik, material ndërtimor dhe material për pajisje të teknologjisë informative) dhe depon në Graçanicë (posedon material i cili nuk është pronë e MAP-it, por e ministrive të linjës dhe Agjencive ekzekutive, gjithashtu edhe material që është trashëguar nga Institucionet humanitare ndërkombëtare). Sipas raportit kthyes të MAP-it është duke punuar që gjatë vitit 2013 me dy komisione si: ai për identifikim të pasurisë dhe ai për vlerësim të pasurisë, të cilat do të bëjnë inventarizimin, vlerësimin dhe më pastaj do të vendoset për asgjësimin e materialit të panevojshëm, por si Komision nuk kemi rezultatin.

Artan Venhari, zëvendës auditor – Konfirmojmë se gjatë auditimit të depos në Rilindje regjistri është kryer, ndërsa depoja në Graçanicë është jofunksionale, sepse pjesa më e madhe e materialeve në atë depo janë materiale të dëmtuara të ministrive, por ka edhe materiale që ruhen. Sugjerimi i ZAP-it është që të krijohet një Komision ndërministror për regjistrimin dhe vlerësimin e stoqeve, në mënyrë që të merren vendime, pastaj se cilat materiale duhet të asgjësohen, cilat materiale duhet të shpërndahen nëpër ministri, ose cilat nga materialet mund të jepen si donacion.

Murselj Haljili – Tha se së pari duhet të vërtetojmë se cilat nga institucionet kanë materiale në këtë depo pastaj, të analizohet se si të veprohet me atë material.

Kryetari – Propozoi që Komisioni duhet t'i kërkojë MAP-it të formojë një Komision ndërministror për vlerësimin dhe regjistrimin e materialit në depon në Graçanicë, dhe i njëjti të dalë me vendime konkrete lidhur me këto materiale.

Ramiz Lladrovci – Propozoi që Komisioni ndërministror, në radhë të parë, duhet të bëjë një listë të materialeve dhe të institucioneve se kujt i përkasin ato materiale, si dhe t'i kufizohet afati kohor se kur MAP-i duhet ta dorëzojnë këtë informacion në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

b). Përdorimi i Automjeteve Zyrtare

Kryetari - MAP përmes Njesisë për monitorim dhe përdorim të automjeteve qeveritare, ka arritur të përgatisë një bazë të të dhënave për ta prezantuar para shefave të transporteve të njësive të ministrive të linjës (kjo do të mundësonte një raportim me të lehtë). Ishte i mendimit

se ky është një hap pozitiv, por që duhet finalizuar. Propozoi që Komisioni të kërkojë që MAP-i të ju imponoj ministrive përdorimin e sistemit të kontrollimit të automjeteve.

Ramiz Lladrovci – Unë mendoj që MAP-i duhet të sjellë një listë të saktë të automjeteve të cilat i ka funksionale edhe të automjeteve të cilat i ka jashtë përdorimit, veturat të cilat duhet të servisohen, pastaj ato të cilat duhet të shiten në ankand publik. Këto të dhëna janë të domosdoshme, sepse MAP-i është i ngarkuar me këto automjete e që realisht ne nuk kemi informata sa janë ato dhe si është gjendja e tyre.

Valbona Dibra – Tha se MAP në raportin kthyes ka prezantuar një plan lidhur me këtë çështje. Mbetet që ZAP ta përcjellë implementimin e tij.

Imri Ahmeti – Edhe pse eksiton një Udhëzim Administrativ lidhur me këtë çështje, megjithatë fuqia e implementimit do të jetë i diskutueshëm, sepse ministritë nuk respektojnë një udhëzim të një ministrie tjetër. Me këtë do të duhej të merrej Zyra e Kryeministrit. Problemi i menaxhimit të automjeteve nuk është problem i vetëm një ministrie, por është problem i të gjitha institucioneve, agjencive të pavarura edhe ndërmarrjeve publike edhe të gjithëve ku menaxhohen me pasuri shtetërore. Njësia monitoruese që është në kuadër të kësaj ministrie që sipas kësaj natyre është jofunksionale dhe do të jetë e tillë nëse nuk ka mbështetjen politike.

Adem Grabovci – Kërkoj që të afatizohet kërkesa e Komisionit që MAP-i të përgjigjet për listën e automjeteve që ka Qeveria në dispozicion. Pastaj, Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete.

c). Trajtimi i E-pasurisë

Kryetari – Gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit kemi pasur vërejtje të shumta në këtë fushë. Kërkesat e shumta të institucioneve për një sistem që do të pasqyronte gjendjen sa me të saktë të mundshme të pasurisë, kanë shtyrë MAP-in të përgatisë një sistem adekuat për regjistrimin e hyrjeve dhe daljeve dhe evidentimin e tyre përmes barkodeve. Kjo ju ka mundësuar organizatave buxhetore që të kenë një pasqyrë reale të pasurisë duke ju falënderuar këtij sistemi. Përkundër kësaj duhet shikuar mundësinë që MAP së bashku me MF të evidentojnë pengesat e këtij mos koordinimi në mes të sistemit të E-pasurisë dhe modulit të Free Balancës në MF.

Valbona Dibra – Në kuadër të Departamentit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, ekziston softweri për regjistrim të pasurisë. Kërkoj që ZAP të monitoroi këtë softwer dhe për fusha të cilat mund të kenë ngecje t`i rekomandoi MF-së për përmirësim. Softweri për këtë ekziston në Free Balanc, prej shumë viteve, në MF.

Artan Venhari – Është e vërtetë se ekzistojnë dy sisteme të ndara. Ekzistojnë dyfishime të punëve me këto sisteme, e që në fakt paraqet probleme për organizata buxhetore. Mirëpo, me modulën e regjistrimit të pasurisë në Free Balanc në MF, nuk ka mundur të llogariten normat e zhvleftësimit të pasurisë dhe me këtë domosdoshmërisht është dashtë që të dhënat të futën edhe në sistem të E-pasurisë në MAP. MAP ka angazhuar programet nga jashtë dhe se këtë problem e ka rregulluar. Deri tani asnjëra nga këto dy institucione nuk kanë kërkuar ndryshim të kësaj çështje.

Adem Grabovci – Unë mendoj se është momenti i fundit që Komisioni t`i detyrojë këto dy ministri që të kenë një koordinim të mirë dhe kjo çështje të rregullohet përgjithmonë. Është duke u keqpërdor pasuria dhe ne duhet t`i ndihmojmë institucionet që të rregullojnë këtë çështje përmes caktimit të një afati kohor, nga Komisioni.

Imri Ahmeti- Këto dy sisteme funksionojë në bazë të dy normave dhe ZKM duhet të nxjerrë

akte juridike të cilat e deshifrojnë qartë se cili institucion është përgjegjës për regjistrimin dhe raportimin për modulën e pasurisë. ZKM mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ me këtë çështje.

Ramiz Lladrovci – Komisioni duhet të organizojë mbledhje të veçantë për trajtimin e E-pasurisë dhe pengesave që kanë këto ministri në përmbushjen e këtij rekomandimi.

Kryetari – Ndau mendimin me deputetin Grabovci që t'i jepet afat MAP-it dhe MF-së që të përgatisin raport, lidhur me situatën e krijuar për modulën e regjistrimit të pasurisë.

d). Qiraja për Institucione

Kryetari – MAP ka mandate ligjore që për institucionet Qeveritare, përveç mirëmbajtjes dhe akomodimit, të bëjë edhe pagesën e qirasë për një pjesë të OB-ve që janë të vendosura ende në objekte private. Sipas raportit të dorëzuar pagesa mujore për muajin janar 2013 ishte në shumën prej 548,493.80 euro edhe atë për 26 institucione buxhetore që llogaritet në pagesa vjetore mbi 6.5 milionë euro. Mirëpo në raportin kthyes nuk flitet për shumën e mjeteve për institucionet e pavarura që nuk janë nën administrimin e MAP-it. Kjo është një shumë e madhe e mjeteve që paguhet për 96,000 m² të shfrytëzuara. Gëzon fakti se në raport janë paraqitur edhe disa objekte që janë në përfundim të sipër dhe kjo e lehtëson sadopak problemin e akomodimit të institucioneve. Mendoj se MAP duhet të na jap informacion edhe për institucionet e pavarura.

Imri Ahmeti – Raportit i mungojnë disa të dhëna. Fillimisht sa i përket shumave të mjeteve të paraqitura në raport, po ashtu mungojnë të dhënat për shumën e mjeteve të kontraktura në emër të qirasë. Mungon e dhëna për sipërfaqen në m² për qiratë e paguara. Shuma është e madhe, mirëpo këtë e përcakton tregu. Në tabelën e ofruar nga MAP-i mungojnë të dhënat për disa Organizata Buxhetore që në realitet paguajnë qira.

Ramiz Lladrovci – Ekzistojnë specifika në pagesën e qirasë, duhet të kihet parasysh se këtu është edhe Ministria e Punëve të Jashtme që paguan qira për ambasadat dhe shumën e pagesës mund të jenë të larta. Mirëpo, tani një pjesë e konsideruar e institucioneve është vendosur në objekte qeveritare, dhe se shumën e mjeteve besojë në të ardhmen do të zvogëlohet.

Adem Grabovci – Raporti nuk është i plotë dhe se MAP-i është dashtë të caktojë edhe afatet se deri kur objektet e caktuara duhet të jenë gati për akomodim. Komisioni duhet t'i caktojë afat MAP-it për raport me shkrim dhe për një plan dinamik për m² të shfrytëzuara nga institucionet.

Kryetari – Kjo është një çështje e vështirë për ta zgjidhur, kemi progres në këtë fushë. Tani është koha që Komisioni të kërkojë një plan konkret të veprimit për akomodimin e këtyre 26 institucioneve në objektet qeveritare, por edhe të Agjencive të Pavarura. Plan i Veprimit të diskutohet në nivel Qeveritar. Informatat e dorëzuara janë të pjesshme.

Ramiz Lladrovci – MAP ka paraparë në fshatin Hajvali, një sipërfaqe prej 37 hektarë, dhe në këtë rast ne duhet të kërkojmë një të dhënë për shumën e mjeteve të parapara me kontrata për shfrytëzim të këtyre hapësirave për tërë vitin, jo vetëm pagesat për një muaj, si në rastin konkret.

Kryetari – Kërkojmë nga MAP që të përgatisë një plan dinamik të veprimit për akomodimin e të gjitha institucioneve, përfshirë këtu edhe Agjencitë e Pavarura, një plan që përmban planin dinamik të akomodimit, metër katrore të shfrytëzuara, si dhe pjesën tabelore të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik nga institucionet në emër të qirasë.

Përfundim

1. Të kërkohej nga Ministria e Administratës Publike që:
 - Brenda afatit prej tre muajsh, të bëjë listimin e materialeve që posedon MAP-i në depon në Graçanicë, me të dhënat se cilit institucion i përket ai material.
 - Të formoj Komision ndërministror për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e këtyre materialeve.
 - Brenda afatit prej një muaji, të bëjë identifikim e saktë të automjeteve zyrtare që janë në përdorim dhe jashtë përdorimit, si dhe çështjen e përdorimit të automjeteve zyrtare të zgjidhë me ministritë, ose përmes Qeverisë të obligojë ministritë që t'i përmbahen sistemit të kontrollit elektronik të përdorimit të automjeteve.
 - Brenda afatit prej tre muajsh, të bëjë listimin e materialeve që posedon MAP-i në depon në Graçanicë, me të dhënat se cilit institucion i përket ai material.
 - Të formoj Komision ndërministror për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e këtyre materialeve.
 - Me raport me shkrim ta njoftojë Komisionin me listën e saktë të të gjitha institucioneve të cilat janë të akomoduar në objekte private, të ofrojë të dhëna të sakta për shumën e mjeteve që paguhet për qira të këtyre institucioneve, sipas kontratave të nënshkruara dhe metrave katrorë të shfrytëzueshme, e për të cilat paguhet qiraja.
 - Brenda afatit prej një muaji, të bëjë identifikim e saktë të automjeteve zyrtare që janë në përdorim dhe jashtë përdorimit, si dhe çështjen e raportimit për përdorim të automjeteve zyrtare të zgjidhë me ministritë, ose përmes Qeverisë të obligojë ministritë që t'i përmbahen sistemit të kontrollit elektronik të përdorimit të automjeteve.
2. Lidhur me këto kërkesa, Ministria duhet ta njoftojë Komisionin, me raport me shkrim, brenda afateve të përcaktuara nga Komisioni.
3. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it dhe të Komisionit nga Ministria e Administratës Publike, dhe ta ndihmojë atë në përmbushjen e këtyre rekomandimeve.
4. Lidhur me trajtimin e E-Pasurisë, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, do të organizojë mbledhje të veçantë, ku do të trajtohen pengesat e mosfunksionimit të sistemit E-pasuria dhe mungesa e koordinimit në mes të Ministrisë së Financave (MF) dhe Ministrisë së Administratës Publike (MAP). Të ftuar në këtë mbledhje do të jenë: Ministri i MF-së, Ministri i MAP-it dhe Auditori i Përgjithshëm.

4. Të ndryshme

a) Përzgjedhja e auditorit të jashtëm, i cili do të bëjë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it për vitin 2012

Bali Muharremaj – Njoftoi anëtarët e Komisionit, lidhur me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, i cili do të bëjë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it për vitin 2012. Duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar, si dhe në ofrimin e të gjitha dëshmive të nevojshme, ashtu siç ka kërkuar Zyra e Prokurimit Kuvend në termat e referencës, Komisioni vlerësues vendosi ta përzgjedhë operatorin ekonomik “BDO KOSOVA” fitues të tenderit, sipas kriterit çmimi më i lirë.

b) Diskutim rreth shqetësimeve të ngritura për menaxhimin e stafit në ZAP

Valbona Dibra – Propozoi që Komisioni të kërkojë nga ZAP-i, raport me shkrim rreth situatës së krijuar në ZAP lidhur me menaxhimin e stafit dhe shqetësimet të cilat kanë dalë në opinion. Për këto shqetësime deputetët janë informuar nga mediat të cilat kanë kërkuar mendimin e anëtarëve të Komisionit lidhur me dokumentacionet – letrën, e të cilat është dashur t'i këtë Komisioni. ZAP duhet zyrtarisht ta njoftojë Komisionin me raport me shkrim, si dhe me dokumentacionin e sindikatës, pastaj Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete. Komisioni edhe gjatë ristrukturimit të ZAP-it, në disa takime të mbajtura ka pasur pakënaqësi nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe disa herë ka ngritur këtë shqetësim.

Kryetari- Ishte i mendimit që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen e radhës të Komisionit. ndërsa ju, si deputete, nuk është dashur të prononcoheni në emër të Komisionit. Po ashtu, tërhoqi vërejtjen se duhet të merret parasysh që po flasim për një institucion të pavarur në punën e tij.

Valbona Dibra - Personalisht jam deklaruar si deputete – anëtare e Komisionit, e jo në emër të Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Propozimi i deputetes Valbona Dibra, do të trajtohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu